

37610

**V E N D I M**

**“PER REGJISTRIMIN E SHOQUERISE SI PERSON JURIDIK”**

Sot, me date 19/2/2007 ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane, une Gjyqtari Z. Kumi i kesaj Gjykate pasi u njoha me materialin e paraqitur nga Petro Kumi per te regjistruar shoquerine si person juridik :

**KONSTATOVA SE:**

Ne daten 30/1/2007 Ortaku i vetem Petro Kumi themeloi shoquerine “KUMI KONSTRUKSION” Sh.p.k. duke hartuar dhe nenshruar per kete qellim Statutin dhe Aktin e Themelimit te shoquerise sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Ortaku i vetem i shoquerise eshte:

**Petro Kumi**, i biri i Theodhorit lindur ne Himare me 24.02.1963 dhe banues ne Tirane Rr. Siri Kodra, madhor me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar mbajtes i pashaportes me numer 0539783

Kapitali themeltar i shoquerise eshte percaktuar ne shumen 100.000 (njeqindmije) leke

**Objekt i veprimtarise do te jete:**

Zhvillimi i vepritarise ndertimore ne fushen e projektimit dhe zbatimit te veprave private, publike, industriale, turistike, bujqesore etj, si dhe kompletimet e nevojshme per to;

Punime te shtresave te rrugeve dhe ndertimin e ujesjellesave dhe te impianteve vadites.

Punime te restaurimit, muratures, betonit, beton armeje te zakonshme; Punime te shembjeve dhe punime dheu.

Import-Eksport te mallrave te ndryshme

**Kohezgjatja e veprimtarise** se shoquerise eshte per nje periudhe kohe te pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin e shoquerive tregtare.

**Selia administrative e shoquerise do te jete ne Tirane, Rr. "Gjergj Legisi" Laprake.**

Shoqueria do te administrohet nga Administratori, detyren e te cilit do ta krye Z. Petro Kumi i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e veprimtarise se perditshme te shoquerise, per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoquerise.

Kerkesa e tij eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE:**

Ne baze te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe te Ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

**VENDOSA:**

Pranimin e kerkeses se Znj. Petro Kumi dhe regjistrimin si person juridik te Shoqerise "KUMI KONSTRUKSION" SH.P.K. te themeluar nga Ortaku i vetem:

**Petro Kumi**, i biri i Theodhori lindur ne Himare me 24.02.1963 dhe banues ne Tirane Rr.Siri Kodra, madhor me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar mbajtes i pashaportes me numer 0539783

**Objekt i veprimtarise do te jete:**

Zhvillimi i vepritarise ndertimore ne fushen e projektimit dhe zbatimit te veprave private, publike, industriale, turistike, bujqesore etj, si dhe kompletimet e nevojshme per to;

Punime te shtresave te rrugeve dhe ndertimin e ujesjellesave dhe te impianteve vadites.

Punime te restaurimit, muratures, betonit, beton armeje te zakonshme; Punime te shembjeve dhe punime dheu.

Import-Eksport te mallrave te ndryshme

**Kohezgjatja e veprimtarise** se shoqerise eshte per nje periudhe kohe te pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin e shoqerive tregtare.

Selia administrative e shoqerise do te jete ne Tirane, Rr."Gjergj Legisi" Laprake.

Shoqeria do te administrohet nga Administratori, detyren e te cilil do ta kryeje Z. Petro Kumi i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise, per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise.

Kundra ketij vendimi lejohet ankim.

GJYQTAR  
*Petro Kumi*  
Dyqan 2007

## AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR



"KUMI KONSTRUKSION" SH.P.K.

Ne mbeshtetje dhe zbatim te dispozitave te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "**KUMI KONSTRUKSION**" SH.P.K. (me poshte ne kete akt e quajtur "Shoqeria") nga Ortaku i vetem:

1. **Petro Kumi**, i biri i Theodhori lindur ne Himare me 24.02.1963 dhe banues ne Tirane Rr.Siri Kodra madhor me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar mbajtes i pashaportes me numer 0539783

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 100.000 (njeqindmije) leke dhe zoterohet teresisht nga ortaku i vetem Z.Petro Kumi.

### **Objekt i veprimtarise do te jete:**

Zhvillimi i vepritarise ndertimore ne fushen e projektimit dhe zbatimit te veprave private, publike, industriale, turistike, bujqesore etj, si dhe kompletimet e nevojshme per to;

Punime te shtresave te rrugeve dhe ndertimin e ujesjellesave dhe te impianteve vadites.

Punime te restaurimit, muratures, betonit, beton armeje te zakonshme; Punime te shembjeve dhe punime dhei.

Import-Eksport te mallrave te ndryshme

**Kohezgjatja e veprimtarise** se shoqerise eshte per nje periudhe kohe te pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin e shoqerive tregtare.

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Petro Kumi". It is written in a cursive style with a prominent initial 'P'.

Selia administrative e shoqerise do te jetë ne Tirane, Rr."Gjergj Legisi" Laprake.

Shoqeria do te administrohet nga Administratori, detyren e te cilit do ta kryeje Z. Petro Kumi i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise, per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise.



**THEMELUESI:**

**PETRO KUMI**

# **STATUT**

## **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

### **“KUMI KONSTRUKSION” SH.P.K.**



Ortaku i vetem i shoqerise eshte:

1. **Petro Kumi**, i biri i Theodhori lindur ne Himare ne vitin 1963 dhe banues ne Tirane Rr. “Siri Kodra”, pallati 23, madhor me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar mbajtes i pashaportes me numer 0539783

Ortaku i vetem me vullnetin e tij te lire ka rene dakord te krijoje shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar “**KUMI KONSTRUKSION**” Sh.p.k. dhe miraton kete statut me dispozitat e meposhtme:

#### **KAPITULLI I Legjislacioni, Forma**

##### **Neni 1**

Shoqeria “**KUMI KONSTRUKSION**” SH.P.K., qe ne vazhdim shkurtimisht do te quhet “shoqeria” eshte krijuar ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 “Per Shoqerite Tregtare” dhe te dispozitave perkatese te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

##### **Neni 2**

Forma juridike e shoqerise eshte ajo e “shoqerise me pergjegjesi te kufizuar” prandaj ortaket perballojne humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Shoqeria fiton personalitet juridik qe nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj, Statutin dhe Aktin e Themelimit.

A handwritten signature in black ink, appearing to read "P. Kumi".

## **KAPITULLI II Emertimi, Selia, Kohezgjatja**

### **Neni 3**

Emertimi i shoqerise eshte:

### **“KUMI KONSTRUKSION” SH.P.K.**

  
Ne cdo akt te leshuar nga shoqeria eshte e detyrueshme te deklarohet “**KUMI KONSTRUKSION**” Sh.p.k. (inicialet Sh.p.k. perfaqesojne tipin e Shoqerise)

### **Neni 4**

Selia administrative e shoqerise do te jete ne Tirane, Rr. "Gjergj Legisi" Laprake. Shoqeria mund te hape filiale, dege dhe/ose agjensi brenda ose jashtे territorit te Republikës se Shqiperise sipas nevojave te saj me vendim te Asamblee se Ortakut te Veten.

### **Neni 5**

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte per nje periudhe kohe te pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin e shoqerive tregtare.

## **KAPITULLI III Objekti**

### **Neni 6**

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

Zhvillimi i vepritarise ndertimore ne fushen e projektimit dhe zbatimit te veprave private, publike, industriale, turistike, bujqesore etj, si dhe kompletimet e nevojshme per to;

Punime te shtresave te rrugeve dhe ndertimin e ujesjellesave dhe te impianteve vadites.

Punime te restaurimit, muratures, betonit, beton armeje te zakonshme; Punime te shembjeve dhe punime dhei.


Import-Eksport te mallrave te ndryshme

## **KAPITULLI IV Kapitali Themeltar**

### **Neni 7**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 100.000 (njeqindmije) leke.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar perfaqesohen nga kontribute ne para dhe shlyhen teresisht ne momentin e nenskrimit te tyre nga Ortaku i vetem.



**Neni 8**  
**Pjeset e Kapitalit Themeltar**

Pjeset e kapitali themeltar jane te barabarta ne vlore dhe te pandashme. Ato i japin te drejten ortakeve te marrin dividente.

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashegimie per shkak vdekje. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjesë ne shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojnë te pakten  $\frac{1}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar. Ortaku cedues duhet t'u komunikohet ortakeve te tjere me anen e nje letre rekomande kushtet e cedimit, perfshire cmimin, kushtet e pageses dhe elemente te tjera percaktues te shitjes. Brenda 3 muajve nga njoftimi i kryer nga ortaku cedues ndaj ortakeve te tjere, keta (ortaket e tjere) mund te ushtrojne te drejten e parablerjes mbi kuotat e ceduara ne kushtet e percaktuara te cedimit, c'ka duhet t'i komunikohet ortakut cedues me anen e nje letre rekomande. Ne rast se e drejta e parablerjes nuk ushtrohet, ortakut cedues i lind e drejta te shese kuoten e vet te treteve ne te njejtat kushte. Ndryshimi i kushteve te cedimit duhet t'u komunikohet ortakeve te tjere me ndryshimet perkatese te kryera. Afati i ushtrimit te se drejtes se parablerjes fillon edhe njehere nga fillimi.

Secila pjese e kapitalit themeltar i jep ortakeve te drejten e nje vote ne Asamblene e Ortakeve.

**Neni 9**  
**Zmadhimi i kapitalit**


Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve. Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet me derdhje ne para ose me kontribute ne natyre, ne kete rast keto kontribute duhet te shoqerohen me nje raport vleresimi teknik te kryer nga nje ekspert i vleresimit te kontributeve, te emeruar nga Asambleja e Ortakeve dhe qe duhet t'i bashkelidhet vendimit te Asamblese se Ortakeve.

Fondet ne para per zmadhimin e kapitalit themeltar do te depozitohen ne llogarine bankare te shoqerise brenda tete ditesh nga data e vendimit te Asamblese se Ortakeve per zmadhimin e kapitalit.

**Neni 10**  
**Zvogelimi i kapitalit**

Zvogelimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve.

Ne asnjë rast Kapitali themeltar nuk mund te jetë me i vogel se vlera minimale e caktuar me ligj, ne rast te kundert shoqeria detyrohet te ndryshoje formen juridike ose te prishet.



**Neni 11**  
Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

Çdo Ortak i Shoqerise ka te drejte te marre ne cdo kohe dhe te kontrolloje reportin e administrimit, iventaret dhe llogarite vjetore, per tre vitet e fundit financiare, si dhe mund te ndihmohet nga nje ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nenshtrohet detyrimit per te ruajtur sekretin profesional.

Çdo Ortak i Shoqerise ka te drejten e pjesemarrjes ne shperndarjen e fitimeve te shoqerise ne perputhje me kontributin e tij ne kapitalin e shoqerise.

Çdo Ortak i Shoqerise gezon te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne Asamblene e Ortakeve ne perputhje me kontributin e tij ne kapitalin e shoqerise. Cdo pjese e shlyer e kapitalit themeltar i jep ortakeve te drejten e nje vote.

Çdo Ortak i Shoqerise eshte i detyruar te derdhi kuoten e tij te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

**KAPITULLI V Administrimi i shoqerise**

**Neni 12**  
Organet drejtuese

Organet drejtuese te Shoqerise jane:

- Asambleja e Ortakeve
- Administratori

**Neni 13**  
Asambleja e Ortakeve


Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte vendimares i shoqerise. Ne te marrin pjese ortaket me te drejte vote sipas kuotave te vena ne krijimin e shoqerise.

Vendimet e Asamblese se Ortakeve shenhen ne nje register qe mbahet ne seline e shoqerise.

Adresa e ortakeve, per cfareolloj reporti me shoqerine, eshte ajo e shnuar ne librin e ortakeve.

Asambleja e Ortakeve gezon te gjitha kompetencat me te larta te vendimmarrjes ku perfshihet emerimi dhe shkarkimi i Administratoreve, miratimi i rapportit te administrimit, iventareve dhe llogarive vjetore brenda gjashte muajve nga dita e mbylljes se vitit finanziar, vendos per ndryshimet statutore, si edhe çdo kompetence tjeter qe i akordohet nga ligji.

Asambleja e zakonshme apo e jashtezakonshme mund te mbahet qofte ne ambjentet e selise se shoqerise apo ne vende te tjera duke njoftuar ortaket me leter rekomande te



pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese. Ne kete leter njoftohet rendi i dites dhe gjithashtu mund te perfshihet edhe data e mbledhjes se dyte ne rast se e para anullohet.

Lajmërimi bëhet nga administratori ose, në mungesë të tij, nga eksperti kontabël i autorizuar. Një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 10 pér qind të pjesëve të kapitalit themeltar, mund të kërkojnë mbledhjen e asamblesë. Cdo klauzolë e kundërt konsiderohet e pavlefshme. Cdo ortak mund të kërkojë ligjërisht caktimin e një mandatmbajtësi të ngarkuar për thirrjen e asamblesë dhe caktimin e rendit të ditës. Cdo mbledhje e asamblesë e thirrur në mënyrë të parregullt, mund të anullohet. Megjithatë anulimi nuk ka vlerë, në rast se të gjithë ortakët janë të pranishëm ose të përfaqësuar. Asambleja e zakonshme duhet te mblidhet te pakten njehere ne vit, brenda 4 muajve nga mbyllja e vtitit financiar; ne raste te vecanta me vendim te mblokuar te organit administrativ, asambleja mund te mblidhet brenda 6 muajve nga mbyllja e vtitit financiar.

Në mbledhjen e Asamblese se Zakonshme vendimet merren nga një ose disa Ortake që përfaqësojnë me shume se gjysmen e pjesave te kapitalit themeltar.

Në mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme vendimet merren gjithmone nga Ortaket te cilet përfaqësojnë shumicen prej  $\frac{3}{4}$  te pjesave te kapitalit themeltar.


Në mbledhjen e asamblese mund te marrin pjesë te gjithe personat qe rezultojne te regjistruar ne librin e ortakeve deri ne daten e mbledhjes. Cdo ortak ka te drejte te marre pjesë ne vendime dhe disponon një numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Nje ortak mund te përfaqësohet edhe nga një person i trete jo ortak. Me kerkese te ortakeve, qofte edhe te njerit prej tyre, pa qene e nevojshme te merret vendim per kete, mund te marrin pjesë ne mbledhje te asamblese konsulente si Avokate, Financiere dhe Eksperte te licensuar, te cilet mund te nderhyjne per dhenien e informacioneve specifike ose te jene thjesht degjues.

#### **Neni 14** Administratori

Shoqeria mund te administrohet nga një ose me shume persona fizike qe mund te zgjidhen brenda ose jashte shoqerise.

Emerimi i administratorit behet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Asambleja ka te drejte te ndryshoje numrin e Administratoreve te shoqerise ne cdo moment qe ajo e konsideron te nevojshem.

Administratori i shoqerise eshte Z. Petro Kumi. Administratori caktohet per një periudhe kohe te pacaktuar.



**Neni 15**  
**Kompetencat e Administratorit**

Kompetencat e administratorit jane:

1. Percaktimi i drejtimeve kryesore te Shoqerise
2. Miratimi i planeve dhe llogarise ekonomike pas perfundimit te tyre ne kuadrin e objektit te shoqerise.
3. Propozimet e nevojshme qe i behen Asamblese ne lidhje me ndryshimin e statutit, kapitalit, etj.

Administratori ka gjithashtu te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me tretot ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligjore statuti ia jep shprehimisht Asamblese se Ortakeve.

Veprimtaria e perditshme e shoqerise drejtohet nga administratori, i cili per realizimin e qellimeve te shoqerise ka te drejte t'a perfaqesoje ate dhe ne emer te saj te paraqitet para te gjitha organeve e institucioneve shteterore apo private, te lidhe kontrata si dhe te paraqitet perpara gjykatave te te gjitha shkallev te mbrojtjen e interesave te shoqerise.

Administratori ka te drejte qe me prokure te posacme te autorizoje dhe jape tagrat e nevojshme personave te ndryshem te specializuar ne fusha te ndryshme, gjithmone per mbrojtjen e interesave te shoqerise, per te kryer nje ose disa nga veprimet e lartpermendura.

**Neni 16**

Administratori eshte perjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit ose per faje te kryera dhe deme te shkaktuara gjate administrimit te tij, sikunder percaktohet ne nenin 53 te ligjit "Per shoqerite tregtare".

**Neni 17**

Administratori shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.



## KAPITULLI VI Te ndryshme

### Neni 18 Miratimi i llogarive

Administratori brenda tre muajve nga dita e mbylljes se vitit finanziar harton dhe i paraqet Asamblese se Ortakeve per miratim, raportin e administrimit, iventaret dhe llogarite vjetore.

### Neni 19

Vegrimitaria financiare dhe viti fiskal i shoqerise fillon ne 1 Janar dhe mbyllte ne 31 Dijetor te cdo viti.

### Neni 20

Nga fitimi i realizuar gjate vitit finanziar, pasi te jene zbritur te gjitha shpenzimet dhe po te jete nevoja edhe humbjet e vitit te meparshem, lihet menjane nje shume me vlore jo me pak se 5% e fitimit, e cila nevojitet per formimin e fondit rezerve qe quhet "rezerva e domosdoshme", derisa kjo rezerve te arrije te pakten sa 1/10 e kapitalit themeltar.

Pjesa tjeter e fitimit perdoret sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve.

### Neni 21

Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve ne cdo kohe mund te vendose prishjen e shoqerise, ne vartesi te gjendjes ekonomiko-financiare apo edhe shkaqeve te tjera qe atij mund t'i duken te arsyeshme, prishje e cila detyrimisht sjell nje likuidim qe do te behet sipas procedurave ligjore per likuidimin.

### Neni 22

Per cfare nuk eshte parashikuar ne kete statut referimi do te behet ne dispozitat ligjore qe rregullojn keto marredhenie juridike.

ORTAKU

PETRO KUMI

